



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Patos, më 14/07/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I. OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtimi i mureve mbajtës për përforcim bazamenti në lagjen “29 Marsi” dhe përgjatë rrugës “Ymeraj në fshatin Gjynaqarë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimore 45.

VLERA E FONDIT LIMIT: 45,176,383.96 (dyzet e pesë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2026-2027 dhe AKMC për objektin: “Ndërtimi i mureve mbajtës për përforcim bazamenti në lagjen “29 Marsi” dhe përgjatë rrugës “Ymeraj në fshatin Gjynaqarë”

I ndarë sipas viteve:

16,590,394.16 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, financuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtës Civile (AKMC).

Për vitin 2027

20,277,149.16 (njëzet milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzet e nëntë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, financuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtës Civile (AKMC).

8,308,840.64 (tetë milion e treqind e tetë mijë e tetëqind e dyzet pikë gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, financuar nga Bashkia Patos.

Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar)

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50,480,428.43 (pesëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e tetë pikë dyzet e tre) lekë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Fondi limit = 45,176,383.96 (dyzet e pesë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2026-2027 dhe AKMC.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve financiare 2024, 2025, të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrijnë ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrijnë ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".(i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor kështu e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e

taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kesteve ,prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose **22,588,191,69 lekë**
- a) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohe ose **45,176,383.96 lekë**

Plotesimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
 - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore.
- 2.3.2** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 2.3.3** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, në bazë të VKM Nr. 42 dt 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP-1: Punime germimi ne toke

Kategoria “A”

NP-5: Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Kategoria “B”

N.S-1: Punime për prishjen e ndërtimeve

Kategoria “A”

NS-18: Punime topogjeodezike

Kategoria “A”

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, ose ekuivalente të licensave profesionale për operatorët e huaj.

Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licences sipas marreveshjes së bashkepunit.

➤ **NP-1: Punime germimi në tokë.**

Kategoria “A”

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore

➤ **NP-5: Punime nëntokësore, ura e vepra arti.**

Kategoria “B”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

➤ **NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve**

Kategoria “A”

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

➤ **N.S - 18 Punime topogjeodezike**

Kategoria “A”

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

NP-1	Punime gërmimi në tokë	- Germim dheu themele e plinta me $b > 2m$, ekskavator me goma 0.25m³, shkarkimi në toke > - Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III	Kategoria A	0-20 milion lekë
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	- Struktura monolite betoni C 25/30 > - F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm - Mbushje me çakell pas mureve - F.V. Gjeotekstil 165g/m² - Struktura monolite betoni C 16/20 - Shtrese betoni C 7/10	Kategoria B	21-50 milion lekë
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	- Prishje shtresa betoni - Prishje mure betoni - Prishje mur tulle pa pastrim - Prishje soleta b/a	Kategoria A	0-20 milion lekë
NS-18	Punime topogjeodezike	- Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km - F.V. Tuba plastmasi ø 80 - Shtrese zhavor lumi $t=20cm$ - Shtrese çakelli $t=10cm$, përhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese çakelli mbeturine kave $t=20cm$, përhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese stabilizant $t=10cm$ - Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	Kategoria A	0-20 milion lekë

2.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Librezë pune;
- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë për sipër sipas përqindjes së bashkëpunimit)

Shenim: Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane AK, perpara publikimit te njoftim fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi, Profili strukturist | 1 (një) |
| b. Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder | 1 (një) |

Për këtë duhet te paraqesë

- Kontrate pune te vlefshme,
- Diplome,
- Libreze pune,
- si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim:(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Shenim: Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane AK, perpara publikimit te njoftim fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

2.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, njeri prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
 - Kontratë Pune të vlefshme
- b) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Ekspert zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin ne perputhje me klauzolat ligjit nr. 152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”, neni 49, pika 4.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Në rastin kur eksperti zjarrfikës është i kontraktuar, operatorët ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomë/Certifikatë
- Marrëveshje bashkëpunimi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave:

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 3 (dy) karpentier
- 2 (dy) betonues
- 2 (dy) hekurkthyes
- 1 (një) Specialist të shtresave rrugore
- 2 (dy) Punonjes eskavatorist
- 4 (katër) punonjes automakinist
- 3 (tre) shofer kategoria C
- 1 (një) Buldozerist
- 10 (dhjete) puntor të thjeshtë

I. Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. kontratën individuale të punës të vlefshme;
- b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- c. Certificate të sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione të autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet të jete e leshuar nga shoqeri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqiperise.

II. Për punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.)

(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist ,buldozeriste dhe shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Ne raste kur makinerit dispononohen me qera, këta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si pasojë nuk mund të jenë domosdoshmërisht në listpagesën e shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit – Profili strukturist-** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit konstruktiv. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinier Gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e sakte të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve të ndertimit pjesë e fushes së tij, zbatimin e projektit sipas të gjithë elementëve përkatës topografik.
- **Teknik ndërtimi** (ose ing ndërtimi në zbatim) është përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e punimeve në kantierin e ndërtimit.
- **Karpentier** është përgjegjës për mbërthimin e saktë të kallëpëve, për realizimin e betonimit të elementëve të ndryshëm në objekt.
- **Betonues** është përgjegjës për realizimin e punimeve të betonit të elementëve të ndryshëm në objekt.
- **Elektriçist** është përgjegjës për realizimin e punimeve për zhvendosjen e kabinës box elektrike
- **Hekurkthyes** është përgjegjës për realizimin e punimeve të hekurit në elementet si tra, themel, kollone dhe brez b/a.
- **Shofer** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive në kantier dhe jashtë kantierit për furnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet.
- **Manovratore/Eskavatorist** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive dhe pajisjeve të ndertimit në kantier dhe jashtë kantierit për kryerjen e proceseve të caktuara të punëve (psh. presa/pompa betoni, ekskavatore gërmim, mini fadroma, skrep të llojeve të ndryshme etj) të nevojshme për objektin që prokurohet.
- **Automakinist** është përgjegjës për drejtimin e mjeteve që ngrejne ngarkesa në lartësi (pompe betoni)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 31 (tridhjetë e një) personave, të cilët duhet të**

figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar,

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të ftuesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.10 Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

• Drejtues teknik	2 (dy)
• Karpentier	3 (tre)
• Betonues	2 (dy)
• Hekurkthyes	2 (dy)
• Puntore te thjeshte	10 (dhjete)
• Automakinist	4 (katër)
• Shofer	3 (tre)
• Eskavatorist	2 (dy)
• Buldozerist	1 (një)
• Tenknik Ndërtimi	1 (një)
• Specislist të shtresave rrugore	1 (një)

TOTALI = 31 (tridhjetë e një) Persona ne Staf.

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. kontratën individuale të punës te vlefshme;
- b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- c. Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione (shteterore apo private) te licencuara/akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise”Deshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje grup certifikues e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Për punonjësit eskavatorist dhe automakinist ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale(CAP)per shoferet dhe deshmi aftesimi profesional (DAP) per manovratoret-automakinistet/eskavatoristet, qe te vertetojnë kualifikimin profesinonal te kerkuar,referuar rregullores “Per kushtet,kriteret dhe programet per pergatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhenien e Deshmis se Aftesise Profesionale per perdoruesit e makinerive te renda per punime ndertime dhe toke, si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre “,miratuare me urdhe r nr.200,date 16.5.2019, teMinistris te Infrastruktures dhe Energjitikes.*

Shenim: Argumentimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialiteteve ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.

2.11 Operatori ekonomik per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponoje edhe staf (jo domosdoshmerisht drejtues teknik ne licencen e shoqerise), si me poshte:

- **1 (nje) person i çertifikuar si Specialist per Testimin e Performances se Materialeve/Produkteve te ndertimit/Inxhinier Materiale**

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Per secilin pesetar te stafit te mesiperm duhet te paraqese:

- Kontrate pune te vlefshme
- Diplome
- Libreze pune
- CV perkatese
- Si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

2.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	Në pronësi ose me qira	copë	2
2.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi ose me qira	copë	2
3.	Depozite uji min 5000 litra	Në pronësi ose me qira	copë	1
4.	Fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	copë	1
5.	Eskavator me goma 0.25 m3	Në pronësi ose me qira	copë	1
6.	Rimorkiator	Në pronësi ose me qira	copë	1
7.	Gjenerator /Monogjenerator	Në pronësi ose me qira	copë	1
8.	Miniekskavator	Në pronësi ose me qira	copë	1
9.	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	copë	1
10.	Rrul kompresor gomë cilindër me vibrim jo me pak se 12 ton	Në pronësi ose me qira	copë	1
11.	Rrul ngjeshes gome-cilindër jo më pak se 3 ton	Në pronësi ose me qira	copë	1
12.	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	copë	1

13.	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	copë	3
14.	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	copë	1
15.	Pompë betoni	Në pronësi ose me qira	copë	2
16.	Vibrator thellësie	Në pronësi ose me qira	Copë	2
17.	Makineri për kthim hekuri ndërtimi	Në pronësi ose me qira	copë	1
18.	Makineri për prerje hekuri ndërtimi	Në pronësi ose me qira	copë	1
19.	Tokmak/ngjeshësh nivelues	Në pronësi ose me qira	copë	1
20.	Prerese asfalti	Në pronësi ose me qira	copë	1
21.	Autovinç	Në pronësi ose me qira	copë	1
22.	Dumper kantieri	Në pronësi ose me qira	copë	1
23.	Matrapik	Në pronësi ose me qira	copë	1
24.	Fabrike betoni (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronësi	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	copë	1

Argumentim Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave të largëta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave të largëta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Fadromë me goma** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e për gërmimet e cekta dhe heqjen e shtresave, ngarkim dhe transportim të materialeve në distanca të shkurtra.
- **Eskavator me goma 0.25 m³**: Përdorimi i një eskavatori me goma shërben për gërmime dhe hapjen e themeleve referuar preventivit. Ky mjet është standard në projekte infrastrukturore për shkak të kapacitetit, performancës dhe përshtatshmërisë në terrene të ndryshme.
- **Autovinç** i referohet analizave të preventivit ngritjen, zhvendosjen dhe vendosjen e ngarkesave të renda (Kabina box).
- **Autobetoniere** shërben për përzierjen dhe transportin e betonit të freskët në kantier i cili është prodhuar në impiant, shkarkon betonin në pompë betoni ose direkt në kantier.
- **Pompë betoni** – shërben për hedhjen e betonit në vendet ku autobetoniere nuk arrijnë dot, sic janë objektet në lartësi (muret mbajtës).
- **Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash** i referohet analizave të preventivit për ngjeshjen e shtresave rrugore çakëll, granil.

Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti i referohet analizave të preventivit për ngjeshjen e shtresave rrugore asfaltike.

1.1. Në zbatim të VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të puntorëve dhe personelit si më poshtë:

- Kokore, minimumi 10 copë.
 - Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.
- a.** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
 - leje qarkullimi;
 - çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
 - siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b.** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:
- kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
 - leje qarkullimi;
 - çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)
 - siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c.** Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d.** Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f.** Për mjetet që nuk shenohen në regjistrat publik duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronesinë e tyre apo marrjen me qira të tij.
- g.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Per permbushjen e ketij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formulain përmbledhës të vetdeklarimit të DST-se.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për keto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të vkm-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- **Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- **Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek përdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- **Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalenten ISO 45001-2023 (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e

bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: *Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndërmarrjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.*

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

- **Çertifikatën e sistemit të menaxhimit të trafikut rrugor ISO 39000:2012 (e vlefshme)**, e akredituar nga DPA ose nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me punime infrastrukturore rrugore, të cilat gjatë fazës së zbatimit ndikojnë në qarkullimin e automjeteve, këmbësorëve dhe sigurinë rrugore në zonën ku zhvillohen punimet. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor ka interes të ligjshëm të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë një sistem të certifikuar të menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor, sipas standardit ISO 39001:2012.

Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik:

- ka procedurë të strukturuarë për identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve që lidhen me trafikun rrugor gjatë realizimit të punimeve;
- zbaton masa për mbrojtjen e përdoruesve të rrugës, punonjësve dhe komunitetit përreth;
- menaxhon në mënyrë të kontrolluar sinjalistikën e përkohshme, devijimet e trafikut dhe aksesin në zonën e punimeve;
- synon uljen e aksidenteve dhe incidenteve rrugore gjatë ekzekutimit të kontratës;
- vepron në përputhje me praktikën ndërkombëtare për sigurinë rrugore dhe menaxhimin e trafikut.

Duke qenë se punimet për rikonstruksionin e rrugës zhvillohen në ambiente ku ka qarkullim aktiv dhe ndërhyrja në infrastrukturë mund të krijojë rrezik për aksidente, kërkesa për ISO 39001:2012 konsiderohet proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe objektin e kontratës.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik fitues të ketë kapacitetet organizative dhe teknike për të realizuar punimet duke respektuar standardet e sigurisë rrugore dhe duke minimizuar ndikimin negativ në qarkullim dhe sigurinë publike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Referuar udhëzimeve dhe rekomandimeve të APP-së, për zërat në preventive që mund të jetë paraqitur marke/brand, origjinë apo prodhim specifik, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë pergatitjes së ofertës ekonomike.

Specifikimet teknike jane bere per permbushjen e nevojave te Autoritetit Kontraktor. Materialet i kane specifikimet e tyre cilesore dhe sasiore sipas zerave te secilit ne preventive dhe ne specifikimet teknike, hartuar per çdo zë punimi sipas preventivit të punimeve, bashkelidhur dokumentave të tenderit.

Të gjitha zërat e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike u hartuan nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile marr në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **30/07/2026, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Ndërtimi i mureve mbajtës për përforcim bazamenti në lagjen “29 Marsi” dhe përgjatë rrugës "Ymeraj në fshatin Gjynaqarë”.**

NJËSIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Boreta Murati

Imela Halimi